



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), si dhe nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12 / 03 maj 2013), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 24 qershor 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN, RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E OPERATORËVE TË SISTEMIT TË PAGESAVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kushteve, kërkesave dhe procedurave sipas të cilave licencohen operatorët e sistemit të pagesave për të vepruar në Kosovë.
2. Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë, efikasitetit dhe sigurisë së sistemit të pagesave, kjo Rregullore përcakton kushtet dhe standardet e zbatueshme për veprimtarinë e operatorëve të sistemit të pagesave.
3. Gjithashtu, kjo rregullore përcakton mjetet dhe procedurat sipas të cilave BQK-ja do të ushtrojë kompetencat e saj rregulluese dhe mbikëqyrëse.
4. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë personat që aplikojnë për licencim në BQK si operatorë të sistemit të pagesave si dhe për çdo operatorë të sistemit të pagesave të cilët aktualisht janë duke operuar në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Nenin 2 të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave dhe/ose siç përcaktohet më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

- 1.1. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- 1.2. **Drejtor** – nënkupton çdo person i emëruar nga aksionarët për të shërbyer si anëtar i Bordit të Drejtorëve të operatorit të sistemit të pagesave.
- 1.3. **Drejtor i pavarur** – nënkupton drejtori që nuk është aksionar dhe është i pavarur nga menaxhmenti i lartë apo individët e ndërlidhur me menaxhmentin e lartë. Individ i ndërlidhur për qëllime të këtij paragrafi nënkupton çdo individ që ka së paku njërën nga marrëdhëniet e mëposhtme me operatorin e sistemit të pagesave:
 - 1.3.1. çdo menaxher i lartë;
 - 1.3.2. çdo person që është i lidhur me menaxherin e lartë, me anë të martesës ose afërsisë së gjakut deri në shkallë të dytë.
- 1.4. **Menaxher i lartë** – kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor për operacione, zyrtari kryesor për rrezik si dhe çdo person i cili i:
 - 1.4.1. raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë apo ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të operatorit të sistemit të pagesave, dhe/ose
 - 1.4.2. është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja.
- 1.5. **Pjesëmarrësit** – pala që përcaktohet/njihet në rregullat e operatorit të sistemit të pagesave si palë e pranueshme për shkëmbim, kliring dhe shlyerje nëpërmjet sistemit të pagesave me pjesëmarrësit e tjerë të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejtë. Pjesëmarrës i drejtpërdrejtë është pjesëmarrësi në një sistem i cili është përgjegjës për shlyerjen e pagesave të tij, të klientëve të tij dhe të pjesëmarrësve jo të drejtpërdrejtë në emër të të cilëve vepron.
- 1.6. **Operator i sistemit** – entiteti që është përgjegjës për operimin dhe/apo administrimin e një sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë.
- 1.7. **Sistem i pagesave ose sistem** – operator i sistemit të pagesave.

KAPITULLI II

LICENCIMI I OPERATORËVE TË SISTEMIT TË PAGESAVE

Neni 3

Parimet e licencimit

1. Ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Sistemin e Pagesave, asnjë person nuk mund të operojë si operator i sistemit të pagesave pa licencim paraprak nga BQK sipas përcaktimeve të Ligjit për Sistemin e Pagesave dhe këtë rregullore.
2. BQK është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e operatorëve të sistemeve të pagesave.

3. Kërkesat për licencim të operatorëve të sistemit të pagesave të përcaktuara në këtë rregullore nuk aplikohen për sistemet e pagesave të cilat menaxhohen nga BQK.

Neni 4

Operatorët e sistemit të pagesave

1. Operatori i sistemit të pagesave është person juridik i regjistruar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i licencuar nga BQK sipas përcaktimeve të Ligjit për Sistemin e Pagesave dhe kësaj rregullore, për të operuar dhe menaxhuar një sistem të pagesave në Republikën e Kosovës.
2. Operator i sistemit të pagesave mund të jetë vetëm:
 - 2.1. BQK-ja;
 - 2.2. Bankat e licencuara nga BQK-ja;
 - 2.3. IFJB e regjistruara nga BQK për ushtrimin e veprimtarisë së lëshimit të parasë elektronike dhe/ose shërbimit të pagesave; dhe
 - 2.4. Shoqëritë Aksionare apo Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara të themeluara sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës dhe të licencuara nga BQK për këtë qëllim.

Neni 5

Agjenti i shlyerjes

Agjent i shlyerjes mund të jetë vetëm BQK-ja apo ndonjë bankë e licencuar nga BQK-ja për të operuar në Kosovë.

Neni 6

Pjesëmarrësit në sistem të pagesave

1. Pjesëmarrës në sistem të pagesave mund të jenë:
 - 1.1. BQK-ja;
 - 1.2. Bankat e licencuara nga BQK-ja;
 - 1.3. IFJB e regjistruara nga BQK për ushtrimin e veprimtarisë së lëshimit të parasë elektronike dhe/ose shërbimit të pagesave;
 - 1.4. Institucionet qeveritare;
 - 1.5. Fondet pensionale; dhe
 - 1.6. Operatorët e infrastrukturave tjera të tregut financiare të licencuar apo të menaxhuara nga BQK.
2. Subjektet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni mund të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në sistem të pagesave.

Neni 7

Kushtet për pjesëmarrje në sistem të pagesave

1. Rregullat për qasje të pjesëmarrësve në sistemet të pagesave, që do të përcaktohen në rregullat e sistemit të pagesave nga operatorët, duhet të jenë objektive, jodiskriminuese, proporcionale dhe nuk mund të pengojnë qasjen më shumë se sa është e nevojshme për të mbrojtur sistemin nga rreziqet specifike të tilla si rreziku i shlyerjes, rreziku operacional dhe rreziku i biznesit dhe për të mbrojtur stabilitetin financiar dhe operacional të sistemit të pagesave.
2. Sistemet e pagesave nuk duhet t'ju imponojnë pjesëmarrësve, përdoruesve të shërbimit të pagesave ose sistemeve tjera të pagesave, ndonjë nga kërkesat e mëposhtme:
 - 2.1. Kufizime për pjesëmarrje në sisteme tjera të pagesave;
 - 2.2. Kufizime në bazë të statusit institucional;
3. Dispozitat e paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk aplikohen për:
 - 3.1. Sistemet e pagesave të përcaktuara nga BQK si të rëndësishme sistemike;
 - 3.2. Sistemet e pagesave të përbëra ekskluzivisht nga pjesëmarrësit që i përkasin një grupi.
4. Për qëllim të nënparagrafit 2.1 të paragrafit 2 të këtij neni dhe kur paragrafi 3 i këtij neni aplikohet, nëse një pjesëmarrës në një sistem të caktuar lejon një ofrues të shërbimit të pagesave që nuk është pjesëmarrës në sistem për të kaluar urdhër transfere përmes sistemit, pjesëmarrësi duhet të ofrojë të njëjtën mundësi në mënyrë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese për ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 8

Kërkesat për kapital

1. Operatori i sistemit të pagesave duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare për ushtrimin e duhur të funksioneve të tij dhe për një operim të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas, të sistemit relevant;
2. Shuma minimale e kapitalit të kërkuar për licencim dhe e mirëmbajtur për operatorët e sistemeve të pagesave është dyqind mijë (200,000) euro.
3. Përveç kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, operatori i sistemit të pagesave duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) e kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Operatori i sistemit të pagesave është i obliguar që së paku 50 % të kapitalit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni ta mbajë në para të gatshme të bllokuar si depozitë me afat në një llogari bankare në bankat e licencuara nga BQK.
5. Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të operatorit të sistemit të pagesave, depozita me afat sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet të jetë në formë të pranueshme për BQK-në dhe duhet të përcaktojë

BQK-në si përfitues i vetëm e cila mund të ekzekutohet vetëm në rast të likuidimit të operatorit të sistemit të pagesave, me miratim paraprak nga BQK.

6. Paga e kapitalit sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni dhe çdo shtesë e mëvonshme e tij duhet të bëhet në para të gatshme dhe shoqërohet me paraqitjen në BQK të informatave lidhur me burimin e këtij kapitalit dhe dokumentin bankar që vërteton pagesën e kapitalit, ashtu siç është e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
7. BQK-ja ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të fondeve, që do të shërbejnë si kapital fillestar ose si shtesë e mëvonshme.
8. Burimet e fondeve të kapitalit duhet të jenë të ligjshme dhe nuk duhet të rrjedhin nga huat nga publiku, kreditë dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.

Neni 9

Aplikimi për licencë për të operuar një sistem të pagesave

1. Subjektet të cilat synojnë të themelojnë një operatorë të sistemit të pagesave duhet të paraqesin në BQK aplikacion për t'u pajisur me licencë si operator i sistemit të pagesave.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga aksionari/ët ose përfaqësuesi ligjor i tij/tyre dhe dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të aksionarit ose përfaqësuesit të aksionarit/ve të propozuar të operatorit të sistemit të pagesave. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Sistem të Pagesave dhe me këtë Rregullore.
3. Kërkesa për licencim të operatorit të sistemit të pagesave duhet të jenë në formë të shkruar e shoqëruar me formularët sipas formatit të BQK-së dhe duhet të përfshijë dokumentacionin / informacionin vijuese:
 - 3.1. Dokumentet e aplikuesit (statuti dhe/ose aktin e themelimit);
 - 3.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
 - 3.3. Listën e aksionarëve dhe aksionarëve përfitues të aplikuesit, duke cekur emrin, nacionalitetin, adresën, historikun afarist the profesional për dhjetë (10) vitet e fundit si dhe posedimin përkatës të aksioneve së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm (për aksionarët kryesor):
 - 3.3.1. Për aksionarët që janë të organizuar si shoqëri tregtare (persona juridik dhe/ose personat fizik) sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare:
 - 3.3.1.1. statuti dhe dokumentacioni i regjistrimit të biznesit (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme / ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit / juridiksionit të huaj);
 - 3.3.1.2. vendimi i organit vendimmarrës të personit juridik dhe/ose personat fizik të organizuar si shoqëri tregtare për pjesëmarrjen në kapital;
 - 3.3.2. Për personat fizik, që nuk janë të organizuar si shoqëri tregtare:

- 3.3.2.1. dokumentin e identifikimit i lëshuar nga shteti, shtetas i të cilit është aksionari i propozuar, dhe adresa e saktë e vendbanimit; dhe
- 3.3.2.2. listën e bizneseve në të cilat ka pjesëmarrje, certifikatat e regjistrimit të biznesit për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi;
- 3.3.3. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin aksionari:
 - 3.3.3.1. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - 3.3.3.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.3.3.3. se personi nuk është i dënuar penalisht;
 - 3.3.3.4. nga Oda e Përmbauesve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - 3.3.3.5. se personi nuk ka dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organ tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese;
 - 3.3.3.6. pëlqimin/autorizimin që i lejon BQK-së verifikim të së kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
 - 3.3.3.7. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e aplikimit në BQK.
- 3.4. Shumën e kapitalit të zotuar të aplikuesit, duke përfshirë dëshminë e pagesës si dhe dokumentacioni për burimin e tij:
 - 3.4.1. deklaratë noteriale të aksionarëve për burimin e kapitalit të paguar dhe se burimi i këtij kapitali nuk është hua nga publiku, kredi dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme;
 - 3.4.2. për aksionarët persona juridik dhe/ose personat fizik të organizuar si shoqëri tregtare, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duke e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.2.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të aplikuesit;
 - 3.4.2.2. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore;

- 3.4.3. për aksionarët personat fizik, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duke e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.3.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - 3.4.3.2. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;
 - 3.4.3.3. kontributet për kapitalin e operatorit të sistemit të pagesave nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.
- 3.4.4. dëshminë nga banka që subjekti ka paguar/bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar.
- 3.5. Planin e biznesit për 5 (pesë) vitet e para të operimit të sistemit të pagesave ku tregohet aftësia e subjektit për përmbushjen e kërkesave organizative, teknike, të personelit dhe tjera me qëllim të operimit të sigurt të sistemit të pagesave. Plani i biznesit duhet të iu referohet të dhënave për aktivitetet e planifikuara të operatorit të sistemit të pagesave, dhe duhet të përmbajë:
 - 3.5.1. një plan për zhvillimin dhe konceptin ekonomik të aktivitetit të subjektit, i cili duhet të bazohet në vlerësime realiste dhe të justifikojë aftësitë e subjektit për të përdorur burimet teknike dhe financiare, si dhe sistemet dhe procedurat në mënyrë të tillë që të garantojë një funksionim normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë, për të cilën subjekti kërkon të licencohet;
 - 3.5.2. parashikimi i gjendjes financiare të aplikuesit për licencim si operator i sistemit të pagesave për 5 (pesë) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së tij pas licencimit, (pasqyrat financiare të parashikuara);
 - 3.5.3. një analizë të rreziqeve ndaj të cilave subjekti dhe/ose pjesëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen, parimet dhe masat për menaxhimin e rreziqeve;
 - 3.5.4. një përshkrim të pajisjeve teknike dhe burimeve të nevojshme për të kryer veprimtarinë, duke përfshirë këtu sisteme të përshtatshme kompjuterike, informatike, kontabël dhe të regjistrimit;
 - 3.5.5. një informacion lidhur me vendndodhjen, ku subjekti parashikon të kryejë aktivitete, pajisjet përkatëse, si dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre; dhe
 - 3.5.6. një përshkrim të strukturës organizative.
- 3.6. Propozimin për rregullat të sistemit të pagesave të përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe nenin 10 të kësaj rregullore.
- 3.7. Kontratë për pjesëmarrje në sistem mes operatorit dhe pjesëmarrësit në sistem të pagesave përmes së cilës pjesëmarrësi i pranon kushtet e operimit të atij sistemi, e cila prodhon efekt ligjor

kur operatori i sistemit të merr licencën nga BQK-ja, apo një draft kontratë ku ceket se palët do të hyjnë në kontratë menjëherë sapo operatori i sistemit të pajiset me licencë nga BQK-ja.

- 3.8. Përshkrimi i sistemit të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm, si dhe përshkrimi i menaxhimit të rrezikut.
- 3.9. Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e drejtorit apo menaxherit të lartë të operatorit të sistemit të pagesave, të cilat duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.9.1. vendimin e organit vendimmarrës për emërim;
 - 3.9.2. dokumentin e identifikimit;
 - 3.9.3. dëshmi për përgatitjen shkollore universitare;
 - 3.9.4. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin për drejtorët, menaxherët e lartë dhe (nëse është e aplikueshme) përfaqësuesin ligjor:
 - 3.9.4.1. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - 3.9.4.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.9.4.3. se personi nuk është i dënuar penalisht;
 - 3.9.4.4. nga Oda e Përmbanuesve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - 3.9.4.5. se personi nuk ka dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organ tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese;
 - 3.9.4.6. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore
 - 3.9.4.7. pëlqimin/autorizimin që i lejon BQK-së verifikim të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
 - 3.9.4.8. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e aplikimit në BQK.
- 3.10. Listën e tarifave të planifikuara për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve;
- 3.11. Dëshminë e pagesës së tarifës për aplikim;
- 3.12. Informata shtesë nëse BQK e konsideron të arsyeshme.

Neni 10

Rregullat e menaxhimit të sistemit të pagesave

1. Rregullat e menaxhimit të operatorit të sistemit të pagesave përfshijnë:

- 1.1. Pjesëmarrësit e mundshëm në sistem të pagesave bazuar në aktivitetin që ata kryejnë;
- 1.2. Kushtet për pjesëmarrje në sistem të pagesave;
- 1.3. Strukturën organizative dhe përgjegjësitë kryesore për çdo funksion ose njësi organizative;
- 1.4. Sistemet dhe procedurat për identifikimin, menaxhimin, kontrollin dhe raportimin e rreziqeve, ku operatori i sistemit ose pjesëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen në të ardhmen;
- 1.5. Sistemet dhe mekanizmat e auditimit të brendshëm, procedurat administrative dhe kontabël, të cilat përfshijnë metodat dhe mjetet e monitorimit dhe kontrollit efektiv të rrezikut, duke përfshirë këtu edhe rrezikun e përdorimit të sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 1.6. Masat të cilat sigurojnë vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të sistemit;
- 1.7. Procedurat dhe masat për shmangien apo zgjidhjen e konflikteve potenciale të interesit që mund të lindin gjatë kryerjes së veprimtarisë;
- 1.8. Përshkrim të organizimit dhe menaxhimit të sistemit të informacionit, duke përfshirë mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit dhe të dhënave personale për pjesëmarrësit apo për subjektet e tjera të interesuara për t'u përfshirë në sistem;
- 1.9. Rregullat e operimit të sistemit;
- 1.10. Kontratë apo draft kontratë me pjesëmarrësit sipas nenit 9 paragrafi 3.7 të kësaj Rregullore, e cila përmban rregullat e përgjithshme dhe procedurat standarde për kliringun dhe/ose ekzekutimin e transferave. Aplikuesi duhet të dorëzojë të paktën tre kontrata apo draft kontrata të nënshkruara me tre pjesëmarrës;
- 1.11. Kriteret e përgjithshme për pranimin, përjashtimin dhe mbikëqyrjen e pjesëmarrësve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- 1.12. Përcaktimin e agjentit shlyerës dhe mënyrën e garantimit të parevokueshmërisë së urdhërtransferit;
- 1.13. Mënyrën e pranimit të urdhër-transferit, si dhe formën dhe strukturën e tij;
- 1.14. Mënyrën e pranimit, si dhe formën dhe strukturën e informacionit për transaksionet në llogaritë e shlyerjes;
- 1.15. Afatet kohore të pranimit të urdhërtransferit, si dhe përcaktimin e çastit kur urdhërtransferi konsiderohet i hyrë në sistemin e pagesës;
- 1.16. Përcaktimin e çastit kur urdhërtransferi konsiderohet si i parevokueshëm nga sistemi i pagesës;
- 1.17. Metodatat të cilat garantojnë fondet për shlyerjen e urdhërtransferave të pranuar në sistem;
- 1.18. Ndonjë rregull tjetër që mund të kërkohet nga BQK.

Neni 11

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e aplikacionit

1. BQK-ja brenda 90 ditësh nga dita e pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e pranuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë Rregullore, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e kësaj Rregullore së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se 90 ditë nga data e njoftimit sipas këtij paragrafi.
3. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara sipas paragrafit 2 të këtij neni janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar.
4. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 90 ditësh nga data e njoftimit sipas paragrafit 2 të këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.
5. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon licencimin si operator i sistemit të pagesave brenda 90 ditësh nga data e njoftimit të aplikuesit se aplikacioni për licencim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja e informon me shkrim aplikuesin. Me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet BQK-së dhe aplikuesit, periudha për marrjen e vendimit sipas këtij nënparagrafi, mund të zgjatet edhe deri 90 ditë tjera.
6. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme.
7. BQK-ja mund të inspektojë zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria e operatorit, me qëllim verifikimin e plotësisimit të kushteve për ushtrimin e tyre.

Neni 12

Kushtet për miratimin apo refuzimin e licencës

1. BQK-ja merr vendim për miratimin e licencës vetëm kur krijon bindjen se operatori i sistemit të pagesave i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave si dhe në këtë rregullore.
2. BQK-ja refuzon miratimin e licencës kur nuk plotësohen kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Ligjin për Sistem të Pagesave dhe këtë Rregullore, si dhe nëse gjatë aplikacionit janë deklaruar informata të rrejshme.
3. BQK-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit e njofton subjektin mbi vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

4. Në rast të refuzimit të licencës nga BQK, aplikuesi ka të drejtë që të paraqes përsëri kërkesë për licencim si operator i sistemit të pagesave.

Neni 13

Karakteristikat e licencës

1. Licenca miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është e transferueshme.
2. Operatori i sistemit të pagesave fillon veprimtarinë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga data e njoftimit për licencim. Nëse brenda kësaj kohe nuk e fillon veprimtarinë, licenca bëhet e pavlefshëm. Operatori i sistemit të pagesave mund të riaplikojë për licencim.
3. Certifikata e licencës për operatorët e sistemit të pagesave lëshohet në pajtim me Rregulloren për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare.
4. Operatorët e sistemit të pagesave, para se të fillojë me veprimtari, duhet ta njoftojë BQK-në për përgatitjet e bëra dhe gatishmërinë për të filluar me ushtrimin e veprimtarisë, për krijimin e hapësirës dhe infrastrukturës së përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë, përfshirë edhe instalimin e sistemit operativ të teknologjisë informative.

Neni 14

Tarifa për aplikim dhe për mbikëqyrje

1. Subjekti që aplikon për licencë të operatorit të sistemit të pagesave duhet të paguajë tarifën për aplikim, sipas shumës së përcaktuar nga BQK-ja. Tarifa e paguar nuk rimburohet edhe në rast të refuzimit të kërkesës për regjistrim.
2. Pas licencimit në BQK operatori i sistemit të pagesave duhet të paguajë tarifë për mbikëqyrje sipas shumave së përcaktuar nga BQK-ja për institucionet financiare jobankare që kryejnë veprimtari të pagesave të pagesave.

Neni 15

Regjistri

1. BQK-ja mban një regjistër publik të operatorëve të licencuar të sistemit të pagesave.
2. Regjistri duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
 - 1.1.Emrin, adresën e zyrës qendrore dhe të dhënat kontaktuese;
 - 1.2.Numri i certifikatës së licencës të lëshuar nga BQK-ja;
 - 1.3.Numri unik identifikues;
 - 1.4.Aktivitetet për të cilat operatori është licencuar;
 - 1.5.Revokimi i licencës së lëshuar ose ndërprerja e aktiviteteve të biznesit.

2. Regjistri i referuar në paragrafët e mësipërm do të jetë i hapur për publikun dhe duhet të përditësohet rregullisht.

Neni 16

Revokimi apo pezullimi i licencës

1. BQK mund të revokojë apo të pezulloj një licencë nëse operatori i sistemit të pagesave:
 - 1.1. nuk ka filluar ofrimin e shërbimit brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas datës së licencimit;
 - 1.2. ka ndërprerë ofrimin e shërbimit për një periudhë prej më shumë se një (1) muaji;
 - 1.3. ka marrë licencën nëpërmjet deklarimeve të pavërtetat apo ndonjë mjete tjetër të parregullt;
 - 1.4. nuk i zbaton kushtet e aplikueshme për licencë në bazë të vazhdueshme;
 - 1.5. ekzistojnë të dhëna të besueshme se aksionarët, drejtorët dhe/ose menaxherët e lartë janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
 - 1.6. ka shkelur ndonjë dispozitë ligjore, ndonjë urdhëresë ose rregullore të BQK-së apo ndonjë kusht ose kufizim, që ndërlidhet me licencën e lëshuar nga BQK-ja edhe pas paralajmërimit të BQK-së;
 - 1.7. dështon në zbatimin e urdhrit të dhënë nga BQK në përputhje me Ligjin për Sistem të Pagesave;
 - 1.8. futet në procedurën e likuidimit;
 - 1.9. rrezikon sistemin financiar në Kosovë;
 - 1.10. nuk është më në interes të publikut apo në interesat e pjesëmarrësve në sistem;
 - 1.11. nuk ofron siguri për pjesëmarrësit në kryerjen e shërbimit të sigurt të pagesave;
 - 1.12. kërkon revokimin apo pezullimin e licencës, në rast të pezullimit BQK-ja me vendim përcakton afatin e pezullimit.
2. Licenca e operatorit të sistemit të pagesave do të revokohet me vendim të BQK-së nëse vlerësohet se operatori i sistemit të pagesave është josolvente ose në mënyrë të arsyeshme pritet të bëhet josolvente.
3. Për qëllimet e këtij neni, “josolvent” do të thotë se operatori i sistemit të pagesave nuk është duke i paguar detyrimet e tij ose vlera e detyrimeve të operatorit të sistemit të pagesave tejkalon vlerën e mjeteve të saj. Vlera e mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të operatoreve të sistemit të pagesave përcaktohet në përputhje me standardet e vlerësimit dhe procedurat e përcaktuara nga BQK-ja.
4. Menjëherë pas marrjes së vendimit për revokim ose pezullim të licencës, BQK e njofton operatorin e sistemit në fjalë, dhe e publikon njoftimin sipas mënyrës që BQK e konsideron të përshtatshëm.

KAPITULLI III TRANSAKSIONET QË KËRKOJNË MIRATIM PARAPRAK

Neni 17

Miratimet paraprake

1. Transaksionet e operatorëve të sistemeve të pagesave që kërkojnë miratim paraprak nga BQK, janë si në vijim :
 - 1.1. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin;
 - 1.2. bashkimi/përvetësimi apo ndarja;
 - 1.3. rritja e kapitalit aksionar;
 - 1.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar;
 - 1.5. të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin te ndryshimi i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në operator të sistemit të pagesave;
 - 1.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
 - 1.7. auditori i jashtëm;
 - 1.8. ndryshimi i rregullave të sistemit të pagesave;
 - 1.9. nënkontraktimi i aktiviteteve;
 - 1.10. shpërndarja e dividendës
2. BQK-ja miraton ose refuzon, në mënyrë të arsyetuar, kërkesën për miratimin paraprak të përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda tridhjetë (30) ditëve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 18 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. Operatori i sistemit për të marrë miratimet paraprake për transaksionet e përcaktuara në nenin 17 paragrafi 1 të kësaj rregullore, paraqet një kërkesë me shkrim pranë BQK-së të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1.1. për ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:
 - 1.1.1. vendimin e organit vendimmarrës;
 - 1.1.2. dokumentin e themelimit dhe/ose statutin e ndryshuar; si dhe
 - 1.1.3. arsyetimi me shkrim për ndryshimin e dokumentit të themelimit dhe/ose statutit.
 - 1.2. për rritja e kapitalit aksionar:

- 1.2.1. nëse rritja e kapitalit aksionar bëhet nga burime të brendshme të tij:
 - 1.2.1.1. deklaratën në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit;
 - 1.2.1.2. raporti i auditorit të jashtëm të operatorit të sistemit të pagesave për vitin paraprak; si dhe
 - 1.2.1.3. pasqyrat financiare të periudhës së fundit të raportuara në BQK, të cilat vërtetojnë mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së kapitalit të IFJB-së.
- 1.2.2. nëse rritja e kapitalit aksionar bëhet nga burimet e jashtme të tij aplikohen kërkesat e nenit 9 paragrafi 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
- 1.3. për zvogëlimin e kapitalit aksionar:
 - 1.3.1. vendimin e organit vendimmarrës;
 - 1.3.2. raporti i auditorit të jashtëm për vitin e kaluar;
 - 1.3.3. një përshkrim të ndikimit të këtij ndryshimi në kërkesat për kapital sipas kësaj rregullore;
 - 1.3.4. pasqyrat financiare që paraqesin gjendjen financiare, nëse ky transaksion do të realizohej; si dhe
 - 1.3.5. arsyetimi me shkrim për zvogëlimin e kapitalit aksionar.
- 1.4. për ndryshimin e pronësisë së aksionarëve, që posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës kërkohet:
 - 1.4.1. raporti i kompanisë aksionarëve për aksionarët e organizuar si shoqëri tregtare apo CV-të e aksionarëve individual sipas formatit të BQK-së;
 - 1.4.2. emri, nacionaliteti, vendbanimi dhe historiku afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit të paraqitësit të kërkesës, dhe çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës që, si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit si dhe informatat / dokumentacioni e kërkuar në nenin 9, paragrafi 3.3 të kësaj rregullore;
 - 1.4.3. listën e shoqërive tregtare në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet me lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyra dhe adresat e regjistruara të këtyre shoqërive tregtare;
 - 1.4.4. për çdo shoqëri tregtare, pasqyrat e audituara financiare (të audituara nëse është e aplikueshme) për tri (3) vitet e fundit;
 - 1.4.5. burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në ushtrimin e përvetësimit ashtu siç përcaktohet në nenin 9 paragrafi 3.4 të kësaj rregullore; si dhe
 - 1.4.6. marrëveshjen e noterizuar, të nënshkruar për ndryshimin e pronësisë së aksioneve.
- 1.5. për emërimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë kërkohet:
 - 1.5.1. dokumentacioni sipas nenit 9 paragrafit 3 nënparagrafi 3.9 të kësaj rregullores.

1.6. për emërimin e auditorit të jashtëm kërkohet:

- 1.6.1. propozimi i operatorit të sistemit të pagesave, për emërimin e auditorit të jashtëm;
- 1.6.2. programi i auditimit;
- 1.6.3. përshkrimi i shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;
- 1.6.4. letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;
- 1.6.5. dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo të stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të institucioneve financiare;
- 1.6.6. vërtetimin e lëshuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) në lidhje me rezultatet e kontrollit të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (ky vërtetim nuk do të kërkohet nga BQK-ja derisa KKRF të mund të lëshojë një vërtetim të tillë); si dhe
- 1.6.7. deklaratën me shkrim të auditorit të jashtëm mbi përmbushjen e parimeve të etikës profesionale të përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve “Kodi i etikës për Kontabilistët Profesional”;
- 1.6.8. kërkesat sipas përcaktimeve të këtij nënparagrafi duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 qershor të secilit vit.

1.7. për ndryshimi i rregullave të sistemit:

- 1.7.1. propozimin e ndryshimeve/plotësimeve të rregullave të sistemit të pagesave;
- 1.7.2. shpjegimin e ndryshimeve/plotësimeve të rregullave të sistemit dhe një vlerësim të ndikimit të tyre në menaxhimin e rrezikut në kuadër të sistemit të pagesave;
- 1.7.3. draftrregullin përkatës sipas versionit me ndryshimet e propozuara.

1.8. për nënkontraktimi i aktiviteteve:

- 1.8.1. vendimin e bordit të drejtoreve të operatorit të sistemit të pagesave përmes të cilit është vendosur nënkontraktimi i aktiviteteve
- 1.8.2. përshkrimin e aktivitetit që operatori i sistemit të pagesave kërkon të nënkontrakttojë, si dhe kushtet që duhet të përmbushë pranuesi potencial i aktivitetit të nënkontraktuar, si dhe kohëzgjatjen e nënkontraktimit të aktivitetit;
- 1.8.3. të dhëna mbi pranuesin potencial të nënkontraktimit të aktivitetit, si: emrin, certifikatën e regjistrimit të biznesit, kualifikimet, raportet financiare për tri vitet e fundit (nëse janë të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi për raportim financiar), adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e e-mailit, faqen zyrtare, emrin, mbiemrin dhe detaje të kontaktimit të personit të autorizuar për përfaqësim të pranuesit potencial të aktivitetit të nënkontraktuar;
- 1.8.4. kontratën apo draftkontratën me nënkontraktorin me anë të së cilës operatori nënkontraktkon një aktivitet të tij tek një person tjetër;

- 1.8.5. dokumente që vërtetojnë përvojën e pranuesit të aktivitetit të nënkontraktuar për aktivitetet e njëjta me aktivitetin e nënkontraktuar nga operatori i sistemit të pagesave (nëse ka);
- 1.8.6. dokumentacion që vërteton çdo përvojë tjetër të pranuesit të aktivitetit të nënkontraktuar.
- 1.9. për shpërndarje të dividendës:
 - 1.9.1. vendimin nga aksionari dhe bordi i drejtoreshave për shpërndarjen e dividendës;
 - 1.9.2. parashikimet lidhur me bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, kapitalin bazë, në baza mujore për 12 muajt e ardhshëm, duke reflektuar pagesën potenciale të dividendës;
 - 1.9.3. pasqyrat financiare të audituara për 3 vitet e fundit.
- 1.10. BQK-ja mund të kërkojë edhe dokumente shtesë, përveç këtyre që janë përcaktuara në këtë paragraf.
- 1.11. Kërkesa për miratimin e transaksioneve të lartcekura si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në kërkesë duhet të paraqitet nga operatori i sistemit të pagesave dhe duhet të jetë në njërin nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Kosovës, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet kompetentë.
2. BQK miraton kërkesat e parashtruara nga operatorët e sistemeve të pagesave për transaksionet sipas paragrafit 1 të këtij nenin, vetëm nëse plotësohet kriteret e mëposhtme:
 - 2.1. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:
 - 2.1.1. ndryshimet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, varësisht se për çfarë ndryshimi bëhet fjalë.
 - 2.2. rritja e kapitalit aksionar:
 - 2.2.1. konsiston në burim të ligjshëm të fondeve të kapitalit.
 - 2.3. zvogëlimi i kapitalit aksionar:
 - 2.3.1. ndikimi i këtij zvogëlimi në operatorin e sistemit të pagesave, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në ndikimin që mund të ketë zvogëlimi në qëndrueshmërinë financiare të operatorit të sistemit të pagesave, strukturën e pronësisë së operatorit të sistemit të pagesave dhe përshtatshmërinë e aksionarëve.
 - 2.4. të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin në ndryshim i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në shoqëri;
 - 2.4.1. përvetësimi i propozuar vlerësohet sipas kriterëve të njëjta që zbatohen për miratimin të një kërkesë për licencim të operatorit të sistemit të pagesave sa i përket aksionarëve duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimit të propozuar në qëndrueshmërinë financiare të operatorit të sistemit të pagesave, strukturën e pronësisë së

operatorit të sistemit të pagesave dhe ndikimin që mund të ketë ky përvetësim në mbikëqyrjen e operatorit të sistemit të pagesave nga BQK.

2.5. për emërimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë:

2.5.1. aplikohen kriteret e përcaktuara në nenin 20 paragrafi 3 të kësaj rregullore;

2.6. për emërimin e auditori i jashtëm:

2.6.1. auditori i jashtëm të jetë i licencuar në Kosovë;

2.6.2. auditori i jashtëm të ketë së paku tre (3) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të institucioneve financiare apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin të ketë një eksperiencë të tillë;

2.7. ndryshimi i rregullave të sistemit të pagesave:

2.7.1. rregullat e sistemit të pagesave duhet të jenë të përgatitura në pajtim me Ligjin për Sistemin e Pagesave.

2.8. për nënkontraktimi i aktiviteteve:

2.8.1. Kriteve të përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave.

2.9. për shpërndarje të dividendës:

2.9.1. gjatë vendosjes për të miratuar një kërkesë të tillë, BQK-ja vlerëson ndikimin e kësaj kërkesë në IFJB duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura në qëndrueshmërinë financiare të IFJB-së dhe pozicionin e tyre në industrinë e IFJB-ve.

KAPITULLI IV TRANSAKSIONET QË KËRKOJNË NJOFTIM PËR BQK

Neni 19

Detyrimet për njoftim

1. Operatori i sistemit të pagesave njofton menjëherë BQK-në në rastet e:

1.1. paaftësisë paguese ose ndërprerjen e veprimtarisë së pjesëmarrësve në sistem;

1.2. problemeve në funksionimin e sistemit, duke përfshirë masat korrigjuese të ndërmarra;

1.3. vlerësimin se ka shkaqe të justifikuar për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë prej aktiviteteve të sistemit; dhe

1.4. çdo ndryshimi në listën e pjesëmarrësve të sistemit.

2. Operatori njofton BQK-në brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike për:

2.1. ndryshime në strukturën organizative;

- 2.2. ndryshim e adresës dhe/ose të dhënave kontaktuese;
 - 2.3. largimin/dorëheqjen e çdo drejtori dhe/ose menaxheri të lartë;
 - 2.4. riemërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
 - 2.5. ndryshime në përmbajtjen e kontratave me pjesëmarrësit dhe në kontratat me operatorët e tjerë.
3. Operatori i sistemit të pagesave njofton BQK-në së paku 30 (tridhjetë) ditë më herët për ndryshimin e tarifave të aplikuara ndaj pjesëmarrësve, mënyrën e llogaritjes së tyre dhe arsyeshmërinë e ndryshimit të tarifave.

KAPITULLI V

ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I OPERATORËVE TË SISTEMIT TË PAGESAVE

Neni 20

Qeverisja e sistemit të pagesave

1. Veprimtaritë e një operatori të sistemit të pagesave qeverisen dhe menaxhohen nga dhe nën drejtimin e organeve të veta ekzekutive, në pajtim me Ligjin për Sistemin e Pagesave, këtë rregullore dhe me statutin e institucionit. Operatori i sistemit të pagesave duhet të veprojë në pajtim me parimet e pranuar të qeverisjes së mire për të siguruar që biznesi i institucionit zhvillohet në mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë. Operatori i sistemit të pagesave duhet t'i përmbahet të gjitha rregulloreve dhe urdhërësive të zbatueshme të nxjerra nga BQK-ja.
2. Operatori i sistemit të pagesave, qeveriset nga bordi i drejtorëve i cili emërohet nga aksionarët ose pronarët dhe i cili përbëhet nga një numër tek prej jo më pak se (3) tre anëtarë me shkollim të ndryshëm, nga të cilët shumica duhet të jenë të pavarur dhe joekzekutiv.
3. Drejtorët dhe menaxherët e lartë të operatorëve të sistemeve të pagesave, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:
 - 3.1. të kenë diplomë universitare në ekonomi, teknologji informative, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 3.2. të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër përkatëse dhe/apo të konsideruar të përshtatshme nga BQK;
 - 3.3. të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - 3.4. të mos jenë të larguar nga posti në një institucion financiar nga BQK-ja;
 - 3.5. të mos jenë të dënuar nga një gjykatë penale për veprë penale për të cilën personi është dënuar me burgim prej një viti a më shumë, ku nuk ka ekzistuar opsioni i gjobës;

- 3.6. personi i dënuar për krime ekonomike ose që është gjetur fajtor për vepra penale ekonomike sipas Kodit Penal;
 - 3.7. nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit;
 - 3.8. të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;
 - 3.9. të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara.
4. Bordi i drejtorëve dhe anëtarët e tij mund të delegojnë detyrat, por nuk mund t'i delegojnë përgjegjësitë e veta tek të tjerët.
 5. Bordi i drejtorëve duhet ta emërojë kryeshefin ekzekutiv ose menaxherin e përgjithshëm dhe menaxherët e tjerë të lart. Bordi drejtues duhet të takohet së paku dy herë në vit.
 6. Ky nen nuk zbatohet në rastin kur operatori i sistemit të pagesave është bankë apo IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së pagesave dhe ose lëshimit të parasë elektronike.

Neni 21

Komitetet

1. Bordi i drejtorëve i operatorit të sistemit të pagesave ndihmohet nga së paku dy komitete, për auditim, menaxhimin e riskut, organizimin, administrimin dhe funksionet kontrolluese:
 - 1.1. komiteti i auditimit i cili përfshin dhe kryesohet nga një anëtar i pavarur i bordit të drejtorëve dhe së paku një anëtar i komitetit të auditimit duhet të jetë një ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit;
 - 1.2. komiteti për menaxhimin e riskut; dhe
2. Komitetet e Bordit të Drejtorëve të operatorëve të sistemeve të pagesave përbëhen vetëm nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të Komitetit të Auditimit në të cilin së paku një anëtar i këtij komiteti duhet të jetë një ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit.
3. BQK mund të kërkojë nga operatorët e sistemit të pagesave të kenë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në këtë rregullore.
4. Operatorët e sistemit të pagesave mund të themelojë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në këtë rregullore si dhe komitete tjera në kuadër të menaxhmentit të lartë.
5. Takimet e rregullta të komiteteve thirren sipas kalendarit të caktuar nga bordi i drejtorëve. Takimet e jashtëzakonshme mund të thirren nga dy 2 anëtarë të bordit të drejtorëve ose nga dy anëtarë të komitetit. Një anëtar i bordit të drejtorëve mund të shërbejë në më shumë se një komitet.
6. Ky nen nuk zbatohet në rastin kur operatori i sistemit të pagesave është bankë apo IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së pagesave dhe ose lëshimit të parasë elektronike.

Neni 22
Kryeshefi ekzekutiv

1. Aktivitetet e përditshme të operatorit të sistemit të pagesave janë përgjegjësi e kryeshefit ekzekutiv / menaxherit të përgjithshëm të caktuar nga Bordi i Drejtorëve. Kryeshefi ekzekutiv nuk mund të shërbejë njëkohësisht si kryesues i bordit të drejtorëve.
2. Ky nen nuk zbatohet në rastin kur operatorit të sistemit të pagesave është bankë apo IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së pagesave dhe ose lëshimit të parasë elektronike.

KAPITULLI VI
MBIKËQYRJA E SISTEMIT TË PAGESAVE

Neni 23
Parimet që rregullojnë veprimtarinë e operatorit të sistemit

1. Operatori i sistemit të pagesave kryen veprimtarinë e tij në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të Bankës Qendrore Evropiane (ECB) dhe Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), të udhëhequra nga parimet e menaxhimit të kujdesshëm.
2. Në përmbushje të menaxhimit të kujdesshëm, operatorit të sistemit:
 - 2.1. merr masat e duhura për kufizimin e rreziqeve;
 - 2.2. siguron nivele të larta të transparencës; dhe
 - 2.3. merr masa për funksionimin e vazhdueshëm dhe efikas të sistemit.
3. Sistemet e pagesave të klasifikuara të rëndësisë sistemike nga ana e BQK-së, duhet të jenë në pajtim me Parimet për Infrastrukturat e Tregut Financiar, të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS).
4. BQK-ja për qëllime të mbikëqyrjes së sistemeve të licencuara në bazë të kësaj rregullore do të bëjë publike politikën e mbikëqyrjes, si dhe procedurat specifike për mbikëqyrjen e sistemit në varësi të rëndësisë që ai paraqet për stabilitetin e tregjeve financiare.

Neni 24
Mbajtja e shënimeve

1. Operatorët e sistemit mbajnë të gjitha shënimet e duhura të aktivitetit për qëllimin e Ligjit për Sistem të Pagesave dhe kësaj rregullore për së paku pesë (5) vite.
2. Shënimet mbahen në një medium që mundëson ruajtjen e informacioneve në atë mënyrë që është i qasshëm për referim në të ardhmen nga BQK dhe në atë formë dhe mënyrë që siguron plotësimin e kushteve të mëposhtme:

- 2.1. BQK duhet të jetë në gjendje të ketë qasje në këto shënime pa vështirësi dhe të verifikojë çdo fazë kyçe të procedimit të çdo pagese/shlyerje;
- 2.2. duhet të bëhet i mundshëm çdo korigjim apo ndryshim tjetër, dhe që përmbajtjet e shënimeve para një korigjimi apo ndryshimi të tillë, duhet të jenë lehtë të vërtetueshme; dhe
- 2.3. nuk duhet të jetë e mundshme që shënimet të manipulohen apo të ndryshohen në mënyra tjera.

Neni 25

Raportet financiare dhe auditimi

1. Operatorët e sistemit të pagesave mbajnë llogaritë dhe regjistrat, si dhe përgatisin pasqyra vjetore financiare, që janë adekuate në pasqyrimin e veprimtarisë së tyre dhe gjendjes financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar.
2. Llogaritë dhe pasqyrat financiare përgatiten në atë formë dhe në ato hollësi, si dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar.
3. Operatorët e sistemit të pagesave kërkohet që të përgatisin dhe paraqesin të gjitha raportet dhe pasqyrat, duke përfshirë raportet mujore, tremujore dhe vjetore të pasqyrave financiare, sipas formatit të BQK-së.
4. Operatorët e sistemit të pagesave duhet të kryejnë auditimin vjetor sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar. Auditori i jashtëm duhet të miratohet paraprakisht nga BQK-ja.
5. Operatori i sistemit të pagesave do të ketë auditor të brendshëm. Ky funksion mund edhe të nënkontraktohet nga një shoqëri e specializuar për ofrimin e këtyre shërbimeve. Auditori i brendshëm duhet të miratohet paraprakisht nga BQK-ja. Detyrat e auditorëve të brendshëm mund të specifikohen me rregullore ose urdhëresë të BQK-së.
6. Nëse e vlerëson të nevojshme, BQK rezervon të drejtën për t'i kërkuar operatorit të sistemit të pagesave themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm, brenda strukturës së tij, duke përjashtuar mundësinë e kontraktimit të auditimit të brendshëm.

Neni 26

Raportimi në BQK

1. Operatori i sistemit të pagesave 1 (një) herë në vit dorëzon në BQK raportin e auditorit të jashtëm bashkë me pasqyrat financiare, dhe një shtojcë të posaçme, sipas nenit 25 të kësaj rregullore.
2. Më së voni brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar përkatësisht 30 prill, operatori i sistemit të pagesave duhet t'i dorëzoj në BQK-së raportin e auditorit të jashtëm dhe letrën e menaxhmentit për vitin e kaluar financiar.
3. Operatori i sistemit të pagesave çdo muaj dorëzon në BQK informacion mbi aktivitetin e sistemit në lidhje me:

- 3.1. numrin dhe vlerën e transaksioneve të proceduara;
- 3.2. informacione të tjera të parashikuara në akte nënligjore të BQK-së.
4. BQK-ja mund t'i kërkojë operatorit raportime tjera të rregullta apo ad hoc për çështje të veçanta dhe të cilat operatori i sistemit të pagesave duhet t'i vë në dispozicion për BQK-në sa herë që i kërkohet.

Neni 27

Shtojca e raportit të auditorit të jashtëm

1. Raporti i auditorit të jashtëm së bashku me shtojcat e tij, duhet të dorëzohet në BQK më së voni brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar, përkatësisht deri me datën 30 prill .
2. Shtojca e posaçme e raportit të auditorit të jashtëm përmban:
 - 2.1. Vlerësimin e pajtueshmërisë me rregullat e menaxhimit të rrezikut:
 - 2.1.1. auditori i jashtëm kontrollon dhe vlerëson pajtueshmërinë e rregullave të menaxhimit të rrezikut të sistemit të pagesave, në pajtim me këtë rregullore;
 - 2.1.2. auditori i jashtëm vlerëson mjaftueshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rreziqeve;
 - 2.2. Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm:
 - 2.3. Vlerësimin e sistemit për menaxhim të informacionit:

Neni 28

Publikimi i të dhënave nga sistemi i pagesave

1. Operatori i sistemit do të publikojë dhe azhurnoj në faqen zyrtare të tij në internet informata bazike dhe të dhëna për sistemin të cilin e operon, në veçanti: emrin e sistemit të pagesave, pasqyrat financiare dhe karakteristikat kryesore, zyrën qendrore të operatorit dhe pjesëmarrësit në sistem si dhe të gjitha tarifat e aplikuar për pjesëmarrje në sistem.
2. Operatori duhet të sigurojë që pjesëmarrësit në sistem dhe pjesëmarrësit e mundshëm të kenë qasje në dokumentacion, informata dhe të dhëna lidhur me të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në sistem dhe menaxhimin e rrezikut në atë sistem.

Neni 29

Mbikëqyrja e sistemit të pagesave

1. Sistemet e pagesave që operojnë sipas kësaj Rregullore, duke përfshirë operatorët, si dhe çdo palë e tretë në të cilën një pjesë e shërbimeve janë nënkontraktuar, janë subjekt i mbikëqyrjes nga BQK-ja.
2. Operatorët e sistemit të pagesave, pjesëmarrësit dhe personat e tjerë që janë subjekt i mbikëqyrjes, janë të detyruar ta lejojnë BQK-në që ta ushtrojë procesin e mbikëqyrjes, të përmbahen nga veprimet që mund të pengojnë BQK-në dhe të sigurojnë të gjithë informacionin dhe

bashkëpunimin e përcaktuar me këtë Rregullore apo të kërkuara për kryerjen e mbikëqyrjes nga BQK-ja ose personat e autorizuar nga BQK-ja për të mbikëqyrur sistemin e pagesave ose operatorët.

3. BQK-ja mund të bashkëpunojë me autoritetet e tjera publike të angazhuara në rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe subjekteve të tjerë të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në funksionimin e sistemit të pagesave në Kosovë.
4. BQK-ja mund të shkëmbejë informacione me këto autoritete dhe persona, dhe t'i njoftojë lidhur me të gjeturat relevante gjatë aktivitetit të mbikëqyrjes.
5. BQK-ja mund të bashkëpunojë me autoritetet e vendeve të tjera për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave. BQK-ja ka të drejtën të shkëmbejë informacion me këto autoritete dhe persona dhe t'i njoftojë lidhur me të gjeturat relevante gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes.
6. BQK-ja, nëpërmjet Politikës për Mbikëqyrjen e Sistemit të Pagesave dhe rregulloreve përkatëse, specifikon në detaje parimet dhe mënyrat e mbikëqyrjes.

Neni 30

Qasja në informata

1. BQK-ja mund të kërkojë që operatorët e sistemit të pagesave, çdo pjesëmarrës ose person tjetër që vepron në emër të operatorit të sistemit të pagesave të sigurojnë brenda periudhës së specifikuar në kërkesën e BQK-së, të gjitha informatat që mund të kërkojnë nga BQK-ja.

2. BQK-ja mund të përgatisë dhe publikojë raporte të konsoliduara me informacione të dhënës sipas kësaj Rregullore për qëllime statistikore, deklarata që lidhen me ose rrjedhin nga çdo informacion i ofruar sipas kësaj Rregullore.

Neni 31

Ekzaminimi

1. BQK-ja mund të ekzaminojë çdo operator të sistemit të pagesave si pjesë e procesit të licencimit dhe në baza periodike si pjesë e mbikëqyrjes. Kjo mund të kryhet me ose pa një kërkesë me shkrim ose njoftim paraprak.
2. Në raste të tilla, BQK-ja ka autorizime që të ekzaminojë dhe marrë librat, pajisjet, ose sendet e tjera sipas nevojës për të siguruar pajtueshmërinë me përcaktimet e BQK-së si dhe ka të drejtë të intervistojë stafin.
3. BQK-ja mund të emërojë ekspertë të jashtëm të pavarur apo zyrtarë të saj, për të marrë pjesë në mbledhjet e organeve qeverisëse të operatorëve të sistemit të pagesave. Zyrtarët e tillë të autorizuar mund të japin mendime dhe rekomandime që regjistrohen në procesverbalin e mbledhjeve.

Neni 32

Masat e mbikëqyrjes për sisteme të pagesave

1. Në rast se BQK konstaton shkelje në veprimtarinë e operatorit të sistemit të pagesave, varësisht nga natyra dhe rëndësia e shkeljes, BQK mund të:
 - 1.1. Lëshojë një paralajmërim me shkrim dhe/ose jep udhëzim të detyrueshëm operatorit dhe/ose pjesëmarrësit në sistemin e pagesave;
 - 1.2. Detyrojë operatorin dhe/ose pjesëmarrësit të ndërpresin dhe të korrigjojnë shkeljet brenda një afati kohor të caktuar;
 - 1.3. Urdhërojë operatorin që të përjashtojë një pjesëmarrës të caktuar nga sistemi i pagesave nëse pjesëmarrësi nuk i respekton kërkesat ose rregullat e sistemit;
 - 1.4. Udhëzojë ndryshime në rregullat e sistemit;
 - 1.5. Detyrojë operatorin për të kryer, me shpenzimet e veta, auditimin e brendshëm ose të jashtëm të sistemit ose pjesëmarrësve të tij;
 - 1.6. Vendos ndaj operatorit dhe/ose pjesëmarrësin në sistemin e pagesave një ndëshkim monetar siç përcaktohet me Ligjin për Sistem të Pagesave;
 - 1.7. Vendosë ndalimin e përkohshëm të operatorit të sistemit të pagesave për t'u angazhuar në veprimtarinë e sistemit të pagesave;
 - 1.8. Revokojë licencën e operatorit.

Neni 33

Konfidencialiteti

1. Personat e autorizuar të BQK-së për të mbikëqyrur sistemet e pagesave dhe operatorët e pagesave janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin profesional në lidhje me informatat e marrura gjatë ushtrimit të funksioneve. Në bazë të informacionit të marrë nga aktivitetet e mbikëqyrjes, BQK-ja mund të japë informacione të përmbledhura për një person të tretë, në të cilat informacione operatorët dhe personat specifik nuk janë të identifikuar.
2. Informacioni i marrë gjatë mbikëqyrjes mund të përdoret vetëm nga personat e autorizuar në përmbushjen e përgjegjësisve të tyre të punës dhe në procedurat ligjore lidhur me një veprim kundër një vendimi të lëshuar nga BQK-ja sa i përket mbikëqyrjes së sistemeve ose në një procedurë të ngjashme.
3. BQK-ja mund t'i sigurojë një autoriteti mbikëqyrës të një vendi tjetër informacionin e marrë gjatë procesit të mbikëqyrjes.
4. Autoritetet dhe personat, përveç atyre të parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni, mund tu ofrohet ndonjë informacion, me kusht që autoritetet dhe personat e tillë të kenë detyrimin për të mbrojtur informacionin dhe për të respektuar konfidencialitetin.
5. Çdo informacion i ofruar sipas këtij neni:

- 5.1. do të përdoret vetëm për qëllime specifike ose për procedurën për të cilën ky informacion është vënë në dispozicion;
- 5.2. kur ofrohet për një vend tjetër, duhet të jetë vetëm në formë përmbledhëse ose te agreguar.
6. BQK-ja, sipas marrëveshjeve të aplikueshme, mund të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për aktivitetet e saj të mbikëqyrjes nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera.

Neni 34 **Dispozitat kalimtare**

Për procedurat e licencimit të operatorëve të sistemeve të pagesave dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për miratimin e transaksioneve sipas nenit 17 paragrafi 1 të kësaj rregullore, manuali për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankar do të aplikohet përshtatshmërisht, derisa të përcaktohet ndryshe nga BQK.

Neni 35 **Shkeljet dhe masat përmirësuese**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve civile, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Sistem të Pagesave.

Neni 36 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës